



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR

Nr 10211 Prot

Gjirokastër më 01/11/2020



**RREGULLORE PËR HETIMIN ADMINISTRATIV
TË SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E KONFIDENCIALITETIT
NË BASHKINË GJIROKASTË**

**KREU I
RREGULLA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe përcaktimin e mekanizmave të mbrojtjes së konfidencialitetit në zbatim të ligjit

**KREU II
PROCEDURAT E VEPRIMIT**

**Neni 2
Kryerja e veprimeve procedural**

1. Njoftimet për veprimet procedurale, për të cilat Njësia Përgjegjëse cakton afate, duhet të përmbajnë paralajmërimin e shprehur mbi pasojat e mosrespektimit të afatit.

**Neni 3
Hetimi i drejtpërdrejtë nga ILDKPKI**

1. Sinjalizuesi ka të drejtë të sinjalizojë veprën e dyshuar të korrupsionit tek ILDKPKI-ja në rastet kur;

- a) Njësia Përgjegjëse nuk fillon hetimin administrativ ose përfundon hetimin në kundërshtim me nenin 14 të ligjit nr. 60/2016;
 - b) ekziston dyshimi i arsyeshëm se pritësi i sinjalizimit në Njësinë Përgjegjëse ose persona të lidhur me të janë të përfshirë ose kanë një interes të drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë, pasuror ose personal, në veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit. Sipas rastit, person i lidhur ka të njëjtin kuptim me përcaktimet e bëra në ligjin për tregtarët dhe shoqëritë tregtare ose ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;
 - c) ka arsye të tjera të bazuara për të dyshuar në integritetin dhe paanshmërinë e Njesisë Përgjegjëse në shqyrtimin e sinjalizimit;
 - d) prova e sinjalizuesit, në lidhje me veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit, mund të fshihet ose të shkatërrohet nga organizata.
2. Në rastet e përmendura në pikën 1, të këtij neni, çdo hetim i Njesisë Përgjegjëse, nëse ka filluar, ndërpritet dhe sinjalizimi hetohet në vijim nga ILDKPKI-ja. Në rast se nuk vërtetohen kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, me vendim të arsyetuar, e dërgon sinjalizimin për nisjen ose vijimin e hetimit administrativ tek Njësia Përgjegjëse e organizatës.

KREU III HETIMI ADMINISTRATIV

Neni 4

Parimet e hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja

1. Në kryerjen e hetimit administrativ Njësia Përgjegjëse vepron:
- a) me ndershmëri, paanshmëri dhe efikasitet, duke pasur parasysh interesat legjitim të sinjalizuesit;
 - b) në mënyrë të pavarur nga pikëpamja politike dhe çdo influencë tjetër e padrejtë që mund të pengojë realizimin e detyrave;
 - c) duke shmangur çdo konflikt interesi të mundshëm përpara fillimit të hetimit administrativ;
 - d) duke marrë të gjitha masat e përshtatshme për të mbrojtur dokumentacionin dhe provat lidhur me sinjalizimin nga zhdukja, fshehja, ndryshimi, falsifikimi dhe veprime të tjera, të cilat synojnë asgjësimin e tyre;
 - e) duke ruajtur konfidencialitetin e informacionit dhe të mbrojtë të dhënat në përmbajtje të çdo sinjalizimi;
 - f) duke ruajtur sekretin shtetëror në përmbajtje të një sinjalizimi, në zbatim të ligjit.

Neni 5

Regjistrimi i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokolli dhe elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve, sipas modelit të “ Rregjistrimit për Sinjalizimin e Brendshëm”, të përcaktuar në Aneksin 2 të kësaj rregulloreje.
2. Njësia Përgjegjëse, nuk mund të refuzojë për asnjë shkak, regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 6

Provat në hetimin administrative

1. Njësia Përgjegjëse dokumenton çdo veprim që kryen gjatë hetimit administrativ. Dokumentet e nevojshme për hetimin administrativ merren apo pranohen pa pagesë. Çdo shkelje e detyrimit të zyrtarëve apo të organizatave private për dhënie dokumentacioni shkresor apo dokumenti tjetër provues përbën shkak për fillimin e procedimit ligjor në varësi të shkeljes së konstatuar. Dokumentacioni, në çdo rast, duhet të jetë original ose i njësuar me origjinalin.
2. Njësia Përgjegjëse ka të drejtë të këqyr sende, vende apo dokumentacion me qëllim fiksimin dhe dokumentimin e veprimeve apo të pasojave të veprimtarisë apo praktikës së dyshuar të korrupsionit. Dokumentimi mund të bëhet me procesverbal, me mjete të tjera fotografike e filmike apo në çdo mënyrë tjetër.
3. Faktet tashmë të njohura për autoritetin publik, ose faktet e njohura botërisht dhe faktet e prezumuara nga ligji, nuk kanë nevojë për prova të mëtejshme.
4. Në raste të veçanta, kur Njësia Përgjegjëse vlerëson se ekzistojnë rrethanat për manipulimin apo asgjësimin e dokumenteve shkresore, punonjësit bllokojnë dokumentacionin apo mjetet e tjera provuese. Zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë janë të detyruar të mos kryejnë asnjë veprim mbi këto dokumente gjatë gjithë kohës që ato janë të bllokuara. Në çdo rast mbahet një procesverbal, që nënshkruhet nga anëtarët e Njesisë Përgjegjëse dhe zyrtarët përgjegjës apo personat e tjerë. Zhblllokimi i dokumentacionit bëhet me urdhër të Përgjegjësit të Njesisë Përgjegjëse.
5. Gjatë ushtrimit të detyrës Njësia Përgjegjëse zbaton, për aq sa mund të jetë e përshtatshme, të gjitha mjetet dhe mënyrat provuese të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.
6. Në fund të kontrollit mbahet akt-kontrolli, i cili nënshkruhet nga Njësia Përgjegjëse dhe zyrtarët e organit shtetëror apo personat drejtues në organizatat private. Në rast se këta të fundit nuk janë dakord me përmbajtjen e aktit kanë të drejtë të bëjnë vërejtje dhe të paraqesin kundërshtime. Kopje të argumenteve dhe të dokumenteve kundërshtuese i bashkëlidhen aktit.

Neni 7

Përfundimi i hetimit administrative

1. Njësia Përgjegjëse përfundon hetimin administrativ nëse:
 - a) gjatë hetimit rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar, në këtë rast, Njësia Përgjegjëse njofton menjëherë Organet e Drejtësisë.
 - b) sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, në zbatim të nenit 6, të ligjit nr. 60/2016.
2. Në dosjen e sinjalizimit, shënohen vendimi për përfundimin e hetimit administrativ nga Njësia Përgjegjëse, i arsyetuar për të gjitha shkaqet që kanë çuar në vendimmarrjen përkatëse, si dhe masat e marra në lidhje me sinjalizimin.

KREU IV

RUAJTJA E KONFIDENCIALITETIT DHE TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 8

Konfidencialiteti

1. Gjatë procedurës së hetimit administrativ të sinjalizimit identiteti i sinjalizuesit u bëhet i ditur personave të tretë vetëm me pëlqimin e tij me shkrim.
2. Njësia Përgjegjëse duhet të ruajë në çdo kohë në mënyrë konfidenciale informacionin e lidhur me sinjalizimin, duke mos e përhapur ose transmetuar tek persona të tretë, si dhe të mos e përdorin për qëllime të tjera, përveçse me pëlqimin me shkrim të sinjalizuesit ose për përmbushjen e një detyrimi ligjor.
3. Njësia Përgjegjëse në komunikimet me organizatën ku punon sinjalizuesi ose me çdo subjekt apo autoritet tjetër, respekton detyrimin e konfidencialitetit dhe ua komunikon informacionin e nevojshëm vetëm personave të caktuar për hetimin administrativ ose për marrjen e masave për ndjekjen e fakteve të sinjalizuara, në kuadër të një marrëveshjeje konfidencialiteti mes palëve.

Neni 9

Mbrojtja kundër hakmarrjes

Sinjalizuesi, i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korrupsioni, gëzon mbrojtje ligjore ndaj çdo mase hakmarrëse të marrë ndaj tij, sipas parashikimeve të nenit 18 të ligjit nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve".

KREU V

SHKELJET DHE MASAT ADMINISTRATIVE

Neni 10

Kundërvajtje dhe masa administrative

1. Shkelja e dispozitave të ligjit Nr. 60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", kur nuk përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë si më poshtë:
 - a) çdo veprim hakmarrjeje ndaj sinjalizuesit, dënohet me gjobë nga 300 000 lekë deri në 500 000 lekë;
 - b) shkelja e parimeve të hetimit të sinjalizimit nga punonjësi, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë;
 - c) shkelja e detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit, dënohet me gjobë nga 150 000 deri në 300 000 lekë;
 - d) mosfillimi i hetimit ose përfundimi i hetimit administrativ nga punonjësi, dënohet me gjobë nga 100 000 deri në 300 000 lekë.
2. ILDKPKI-ja ka të drejtë të konstatojë kundërvajtjet dhe të vendosë gjobën. Kundër vendimit të ILDKPKI-së mund të bëhet ankim, sipas ligjit për kundërvajtjet administrative.
3. Të ardhurat nga gjobat kalojnë në Buxhetin e Shtetit.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë!

NJËSIA PËRGJEGJËSE

Alfred Shabani

Nie Shalari